



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 102, datë 28.10.2024

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE FORMULËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË QYTETIN E DURRËSIT

Në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “a” dhe “b”, nenit 23, pika 6, nenit 54, shkronja “k”, nenit 55, pika 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, nenit 100 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I :

1. Miratimin e procedurës dhe formulës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në qytetin e Durrësit, si më poshtë vijon:

a. Për përllogaritjen e subvencionit maksimal për linjë (SML) të zbatohet formula:

$$SML = (KTL/KTP) \times STM$$

SML – Subvencioni maksimal për linjë

KTL – Kilometra totale mujore për linjë

KTP – Kilometra totale në muaj për të gjitha linjat e transportit qytetas sipas kontratës

STM – Subvencioni total mujor



b. Për përlogaritjen e subvencionit që duhet paguar për linjë (SPL) të zbatohet formula:

$$\text{SPL} = (\text{KmFL}/\text{KTP}) \times \text{STM}$$

SPL – Subvencioni që duhet paguar për linjë

KmFL – Kilometrat e përshkruara faktike mujore për linjë

KTP – Kilometra totale në muaj për të gjitha linjat e transportit qytetas sipas kontratës

STM – Subvencioni total mujor

*Në çdo rast, SPL nuk duhet të tejkalojë SML ($\text{SPL} \leq \text{SML}$)

2. Subvencioni që duhet paguar për linjë (SPL) bëhet funksional dhe paguhet, vetëm nëse operatori kryen me mjetet e autorizuar jo më pak se 90% të kilometrave/muaj të përlogaritura për shërbimin e kontraktuar të linjës ($\text{KmFL}/\text{KTL} \geq 90\%$).
3. Subvencioni i përlogaritur jepet deri në momentin e miratimit të rregullave përkatëse për subvencionim për Operatorët e Transportit Publik qytetas nga Këshilli i Ministrave, por jo më shumë se një vit nga miratimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.10.2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

01/11/24 12193/6

Nr. 644/prot.
12

Durrës, më 01.11.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.102 datë 28.10.2024, "Për miratimin e procedurës dhe formulës së shpërndarjes së subvencionimit për operatorët e shërbimit të transportit publik qytetas në qytetin e Durrësit."

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

